# DËSHMI ARKIVI

**A-450796**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | VAR-i as që e shqyrtoi nëse Fernandezi ishte në ofsajd |
| ADRESA | `https://www.koha.net/futboll/var-i-as-qe-e-shqyrtoi-nese-fernandezi-ishte-ne-ofsajd` |
| BURIMI | koha.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 02:17:48 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 19:17:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `5698d2f8c06adba80fe9e599fc3cb1b132923704b3032043f2147f4d2b8040db` |
| TEKSTI | `64499161da805b2e6ec10c877d822af7a2229e9486200382d9cc17b3a8cea6e7` |
| PAMJA | `6332b2e5dcf4b4c24074d6b7a782b85a5051a2fcac9627c693d68982d3149daa` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `99231b0f7f8f6bcdcbfd45c5a5cbbb5d20c85fda52e8ece27a6a1bd691f86027` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `620a3e0ea5360256664d4fe0b9b06d4faf85ac171f0ef56a543d5c170249f92b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/99231b0f7f8f6bcdcbfd45c5a5cbbb5d20c85fda52e8ece27a6a1bd691f86027`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën Kontribuo → Letër lexuesit

FUTBOLL

# VAR-i as që e shqyrtoi nëse Fernandezi ishte në ofsajd



16 shtator 2026 21:17

Shpërndaje në:

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Shefi i arbitrave të Premier Leagues, Howard Webb, ka pranuar se VAR-i as që e mori në konsideratë nëse Enzo Fernandez ndodhej në pozitë jashtë loje, gjatë golit shumë diskutabil të shënuar nga Erling Haaland në derbin e Manchesterit të dielën.

Manchester City fitoi 1:0 ndaj Manchester Unitedit, ndërsa goli i Haalandit ishte shënuar nga pozitë e parregullt.

Webb tha se ishte shumë i zhgënjyer nga gabimi i bërë prej gjyqtarit të VAR-it, Matt Donohue, dhe ndihmësi i tij, Blake Antrobus.

Sulmuesi i Cityt, Haaland, mendoi se kishte shënuar të vetmin gol të ndeshjes në "Old Trafford" në minutën e 60-të. Por fillimisht ai u anulua për shkak të pozitës jashtë loje.

Pas rishikimit të VAR-it, u konstatua se Haaland ishte në pozitë të rregullt dhe goli u pranua.

Edhe



Futboll • 14 sht 2026
Arbitri që pranoi golin e Cityt "përjashtohet" nga Premier League

Megjithatë u bë menjëherë e qartë se zyrtarët e VAR-it kishin bërë gabim duke mos identifikuar shkeljen e pozicionit jashtë loje nga ana e Fernandezit, i cili u hodh drejt topit në një pozicion qendror dhe pengoi kundërshtarët.

"Isha vërtet i zhgënjyer nga ky përfundim. Të gjithë jemi", tha Webb. "Askush nuk e ndien këtë më shumë se vetë gjyqtarët. Ata krenohen shumë me punën e tyre dhe natyrisht që tani ndihen të lënduar, pasi nuk ia dolën siç duhet në këtë situatë", ka shtuar udhëheqësi i arbitrave të Premier Leagues.

Dy arbitrat që gabuan, nuk do të delegohen në ndeshjet e fundjavës.

Një nga pyetjet që kanë bërë shumë tifozë është se si ekipi i

Arbëri.
81 vjet burgim për katër ish-drejtuesit e UÇK-së

Arbëri.
Qytetarët sërish mblidhen para EULEX-it, e gjuajnë me gurë e mjete piroteknike

Arbëri.
Dy protestues u shoqëruan në polici, njëri u ndalua për 48 orë

Kronikë.
Vdiq një 21-vjeçare, u godit nga vetura në fshatin Vlashnje

Futboll.
Humbje për Milanin në Ligën e Evropës

Futboll.
Tjetër goditje për Manchester Unitedin

VAR-it mund të arrinte në përfundim se Fernandez nuk kishte kryer shkelje për ofsajd.

Por Donohue dhe Antrobus nuk e shqyrtuan nëse Fernandez ishte në pozitë jashtë loje. Sipas Webbit, ata u fokusuan vetëm te Haalandi.

Teknologjia gjysmë-automatike e pozicionit jashtë loje i tregoi VAR-it se Haalandi ishte në pozitë të rregullt, me tri centimetra diferencë nga krosimi i Joshko Gvardiol.

Por më pas, arbitrat e VAR-it kontrolluan vetëm nëse kishte pasur ndonjë prekje të topit nga Fernandez, gjë që do të kishte krijuar fazë të re të pozicionit jashtë loje për lojtarin norvegjez.


Edhe



**Futboll** • 13 sht 2026

Premier League sqaron pse goli i Haalandit ishte i rregullt


Webb tha se VAR-i dështoi të vlerësonte se si Fernandez e gjeti veten në atë pozitë, ndaj nuk e mori parasysh shkeljen e mundshme të pozicionit jashtë loje.

“Ky gol duhej të ishte anuluar. Për fat të keq nuk ndodhi kështu. Ne do të shqyrtojmë rastin, do të reflektojmë dhe do të përpiqemi të nxjerrim mësime për të parandaluar përsëritjen e këtij lloji të pazakontë të gabimit”, ka thënë Webb, që ka vënë theksin te mungesa e ndihmës nga asistenti i VAR-it, Antrobus.

#HOWARD WEBB #VAR


## Artikuj të ngjashëm



**Futboll** • 7 o. më parë

Haaland: Unë kurrë nuk jam në pozitë jashtë loje




**Futboll** • 15 maj 2026

Edhe tri gabime të VAR-it konfirmohen në Premier League



**Futboll** • 9 nën 2025

City fiton thellë në derbin e zjarrtë ndaj Liverpoolit



KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

+383 (0) 38 249 105 / [email protected]

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Download on the App Store

GET IT ON Google Play


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.